

Përmbledhje

- **Në TM2 2025, ekonomia e Eurozonës shënoi rritje prej 0.1 përqind, duke reflektuar ngadalësim të dukshëm në krahasim me tremujorin paraprak.** Inflacioni gjithashtu shënoi rënie, duke arritur në 2.0 përqind, në përputhje me objektivin vjetor të BQE-së. **Sa i përket Ballkanit Perëndimor, FMN parashikon rritje ekonomike prej 3.4 përqind në vitin 2025,** mbështetur nga konsumi, investimet dhe shpenzimet publike. Megjithëse rritje e qëndrueshme kundrejt sfidave të jashtme si tensionet gjeopolitike dhe pasiguria në Eurozonë, perspektiva e rritjes mbetet më e zbehtë krahasuar me parashikimet fillestare. Në anën tjetër, inflacioni është rritur me 3.7 përqind, një përshpejtim kundrejt tremujorit paraprak kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimit dhe energjisë.
- **Gjatë TM2 2025, ekonomia e Kosovës shënoi rritje reale prej 4.6 përqind, krahasuar me 4.3 përqind në TM2 2024, e mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit publik dhe investimeve, ndërsa eksporti neto ndikoi negativisht për shkak të rënies së eksportit të mallrave dhe rritjes së importit.** Konsumi privat rezulton të jetë rritur më ngadalë, si pasojë e rritjes më të ngadalshme të burimeve kryesore të financimit të kësaj komponente, në një ambient me shkallë më të lartë të inflacionit. Remitencat dhe investimet publike mbetën faktorë mbështetës në konsumin e përgjithshëm. Rritje të vlerës së shtuar në Bruto Produktin Vendor (BPV) shënuan sektorët e ndërtimit, tregtisë dhe shërbimeve financiare, ndërkohë që sektori i energjisë elektrike kontribuoi negativisht. Për gjithë vitin 2025, BQK parashikon rritje ekonomike prej 3.9 përqind, e mbështetur nga konsumi, investimet dhe eksporti i shërbimeve, ndërsa importi pritet të ketë ndikim negativ.
- **Inflacioni u përshpejtua në 3.7 përqind në TM2 2025, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe shërbimeve.** Çmimet e mallrave tjera mbetën pothuajse të pandryshuara, kurse çmimet e energjisë kontribuan në zbutjen e inflacionit në këtë tremujor. Ecuri rritëse u evidentua edhe në inflacionin bazë i cili rezultoi 2.0 përqind, ndikuar nga rritja e çmimeve të shërbimeve. Sa i përket origjinës, inflacioni pasqyroi presione të kombinuara nga faktorët e jashtëm përmes importit të ushqimit, dhe ekonomisë së brendshme përmes shërbimeve, me dominim të faktorëve të jashtëm.
- **Sektori fiskal shënoi rritje gjatë TM2 2025, si në të hyra ashtu edhe në shpenzime. Të hyrat primare buxhetore arritën vlerën prej 864.5 milionë euro, apo rritje prej 17.0 përqind. Shpenzimet buxhetore arritën vlerën 761.4 milionë euro, duke shënuar rritje prej 15.5 përqind.** Suficiti primar buxhetor arriti vlerën prej 27.6 milionë euro. Të hyrat tatimore shënuan rritje prej 18.1 përqind, duke arritur vlerën e 766.4 milionë euro, me rritje nga tatime direkte dhe indirekte, në veçanti TVSH-ja dhe akciza. Shpenzimet kapitale shënuan rritje të lartë prej 33.3 përqind ndërsa shpenzimet rrjedhëse u rritën për 11.9 përqind. Raporti i borxhit publik ndaj BPV-vë u rrit në 16.0 përqind, ndërkohë borxhi publik u rrit për 6.3 përqind duke arritur vlerën prej 1.77 miliardë euro.
- **Në TM2 2025, deficit i llogarisë rrjedhëse u zgjerua me 27.0 përqind, duke arritur në 455.4 milionë euro, kryesisht për shkak të përkeqësimit të bilancit tregtar.** Megjithatë, sektori i shërbimeve, të ardhurat parësore dhe dytësore patën ndikim pozitiv, duke siguruar burim të qëndrueshëm të të hyrave financiare. Remitencat në këtë tremujor arritën në 363.4 milionë euro, një rritje vjetore prej 4.1 përqind. Po ashtu, Investimet e Huaja Direkte shënuan rritje prej 19.4 përqind, duke arritur vlerën prej 243.6 milionë euro.
- **Sektori bankar u karakterizua me rritje vjetore të përshpejtuar të aseteve, ndikuar kryesisht nga zgjerimi më i shpejtë i aktivitetit kreditues.** Megjithatë, krahasuar me tremujorin paraprak, ritimi i rritjes së kreditimit u ngadalësua dhe stabilizua, si pasojë e ngadalësimit të kredive të reja investuese për korporatat jo-financiare dhe të kredive hipotekare për ekonomitë familjare. Depozitat, ndonëse shënuan rritje të përshpejtuar nga viti i kaluar, krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti kanë pësuar rënie. Norma mesatare e interesit në kredi ka shënuar rritje në fund të qershorit 2025, ndërsa ajo në depozita pësoi rënie, duke zgjeruar më tej hendekun ndërmjet tyre. Cilësia e portfolios kreditore mbetet e mirë, me rënie marginale të nivelit të kredive jo-performuese nga viti paraprak, ndonëse nga tremujori i kaluar ky nivel shënoi rritje të lehtë. Profitabiliteti i sektorit bankar, së bashku me treguesit kryesorë si kthimi mesatar në asete dhe në kapital, shënuan rënie nga viti i kaluar. Nga ana tjetër, pozicioni i kapitalit u forcua më tej, ndërsa treguesit e likuiditetit dhe të financimit vijuan rënien graduale, por vazhdojnë të qëndrojnë mbi nivelin minimal rregullator.
- **Sektori pensional shënoi rikuperim të kthimeve nga humbjet që e karakterizuan sektorin në tremujorin e parë të vitit, si rezultat i përmirësimit të kushteve në tregjet financiare globale. Vlera e aseteve dhe kontributeve vazhdoi rritjen e qëndrueshme. Investimet mbetën të përqendruara në tregjet e jashtme, me ekspozim të lartë në fondet e përbashkëta.**
- **Sektori i sigurimeve shënoi ngadalësim në rritjen e aseteve dhe primeve të shkruara, veçanërisht në segmentin jo-jetë. Në anën tjetër, dëmet e paguara u rritën, ndërsa fitimi neto ruajti një trend pozitiv, i mbështetur nga rritja e të hyrave dhe menaxhimi i qëndrueshëm i shpenzimeve. Treguesit e qëndrueshmërisë dhe likuiditetit për siguresit mbetën në nivele të shëndosha.**
- **Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar vazhdoi rritjen dyshifrore, por me ngadalësim, duke reflektuar trendin e ngadalësimit të rritjes së financimit të jashtëm. Kreditimi u zgjerua si për ekonomitë familjare, ashtu edhe për korporatat jofinanciare, ndërsa lizingu shënoi rënie, veçanërisht në segmentin e korporatave jofinanciare. Fitimi neto shënoi ngadalësim si pasojë e rritjes më të shpejtë të shpenzimeve, ndërkohë që kreditë joperformuese mbetën të ulëta dhe të mbuluara mirë me provizione.**

Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KJF	Korporatat jo-financiare
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
MMBTU	Metric Million British Thermal Unit
WEO	World Economic Outlook

Përmbajtja

Përmbledhje	i
1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	3
2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	5
3. Ekonomia e Kosovës	7
3.1. Rritja Ekonomike	7
3.2. Çmimet	8
3.3. Sektori Fiskal	10
3.4. Sektori i jashtëm	11
4. Sistemi financiar	15
4.1. Sektori bankar	15
4.2. Sektori pensional	25
4.3. Sektori i sigurimeve	26
4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar	28
4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës	32

1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas vlerësimeve preliminare të Eurostat-it, ekonomia e eurozonës gjatë TM2 2025 ka pasur rritje prej 0.1 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, duke paraqitur një ngadalësim të dukshëm krahasuar me rritjen prej 0.6 përqind në TM1 2025. Edhe në terma vjetor, ekonomitë e eurozonës u karakterizuan me një rritje më të ngadalshme vjetore prej 1.4 përqind, krahasuar me rritjen prej 1.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga konsumi i ekonomive familjare, i cili kontribuoi me 0.1 pikë përqindje. Megjithatë, ky kontribut ishte më i ulët se në tremujorin e kaluar, duke reflektuar situatë të pafavorshme ekonomike. Po ashtu, edhe konsumi publik kontribuoi me 0.1 pikë përqindje, me shpenzimet qeveritare që ndihmuan në kompensimin e rënieve në sektorët tjerë. Në anën tjetër, formimi i bruto kapitalit ishte faktori kryesor negativ, me kontribut prej -0.4 pikë përqindje, si pasojë e uljes së investimeve në makineri dhe, në një masë më të vogël, në ndërtimtari. Tensionet gjeopolitike, pasiguritë rreth inflacionit dhe rritjet e kostos së ndërtimit kanë shkaktuar ulje në besimin e kompanive ndërtuese. Investimet në përgjithësi janë prekur nga pasiguria në politika tregtare, sidomos nga tarifat tregtare të vendosura nga SHBA-të. Këto të fundit ndikuan negativisht edhe bilancin tregtar përmes uljes së eksporteve, me kontribut të përgjithshëm negativ prej -0.2 pikë përqindje. Ngadalësimi i importeve pasqyron gjithashtu rënien e kërkesës dhe shpenzimeve të përgjithshme. Në mesin e ekonomive më të mëdha të bllokut, Gjermania ka pësuar rënie me 0.3 përqind, Italia me 0.1 përqind, ndërsa Franca dhe Spanja patën rritje me 0.3 përkatësisht 0.7 përqind. Sa i përket parashikimeve për vitin 2025, BQE ka paraparë rritje ekonomike prej 0.9 përqind.


Inflacioni në eurozonë për TM2 2025 ishte 2.0 përqind, një ngadalësim krahasuar me 2.3 përqind sa ishte në TM1 2025. Kontribuuesit kryesorë në shkallën e inflacionit në eurozonë rezultojnë të kenë qenë shërbimet, me rreth +1.65 pikë përqindje, të përcjellur nga artikujt ushqimorë, alkooli dhe duhani me +0.58 pikë përqindje. Mallrat industriale patën kontribut më modest në rritjen e inflacionit, me rreth 0.14 pikë përqindje. Energjia ishte faktori kryesor që ndihmoi në uljen e shkallës së inflacionit me kontribut negativ prej -0.3 pikë përqindje, për shkak të rënies së çmimeve të energjisë elektrike. Kjo rënie, e cila ka filluar që nga mesi i vitit 2023, gjithashtu ka lehtësuar tregtinë ndërkombëtare dhe ka ndihmuar në uljen e mëtejshme të inflacionit. Gjatë kësaj periudhe, BQE-ja ka ulur normën e huadhënies me nga 0.25 pikë përqindje në muajt prill dhe qershor, duke arritur në nivelin 2.4 përqind. Sipas parashikimeve, inflacioni në eurozonë pritet të ketë rënie në vitet e ardhshme. Megjithatë, eurozona mbetet e rrezikuar nga zhvillimet gjeopolitike në Evropë, Lindje të Mesme dhe SHBA, të cilat mund të pengojnë procesin e zinxhirit furnizues dhe të shkaktojnë rritje të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve.

Inflacioni në eurozonë për TM2 2025 ishte 2.0 përqind, duke shënuar ngadalësim krahasuar me 2.3 përqind sa ishte në TM1. Gjatë kësaj periudhe, BQE-ja ka ulur normën e interesit me 0.25 pikë përqindje në prill dhe 0.25 pikë përqindje në qershor, duke arritur në 2 përqind. Marrë parasysh Nuk ka ndonjë sinjal sa i përket uljes së mëtejshme të normave të interesit, duke qenë se edhe në muajin korrik, norma e inflacionit ka qëndruar stabile në 2 përqind. Megjithatë, BQE-ja ka vendosur që normat e interesit do të përcaktohen në bazë të vlerësimeve të vazhdueshme të inflacionit. Kontribuuesit kryesorë në rritjen e inflacionit ishin shërbimet, me rreth +1.65 pikë përqindje, të përcjellur nga artikujt ushqimorë, alkooli dhe duhani me +0.58 pikë përqindje. Mallrat industriale patën kontribut më modest në rritjen e inflacionit, me rreth 0.14 pikë përqindje. Energjia ishte faktori kryesor që ndihmoi në uljen e inflacionit, me kontribut negativ prej -0.3 pikë përqindje, për shkak të rënies së çmimeve të energjisë elektrike. Kjo rënie, e cila ka filluar që nga mesi i vitit 2023, gjithashtu ka lehtësuar tregtinë ndërkombëtare dhe ka ndihmuar në uljen e mëtejshme të inflacionit. Sipas parashikimeve, inflacioni në eurozonë pritet të ketë rënie në vitet e ardhshme. Megjithatë, eurozona mbetet e rrezikuar nga zhvillimet gjeopolitike në Evropë, Lindje të Mesme dhe SHBA, të cilat mund të pengojnë procesin e zinxhirit furnizues dhe të shkaktojnë rritje të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve.

Vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje mesatare ekonomike prej 3.1 përqind në TM2 2025. Ky ritëm i rritjes përbën rritje të moderuar, që njëkohësisht tregon qëndrueshmërinë e rajonit përballë sfidave strukturore dhe rreziqeve të jashtme që vazhdojnë të rëndojnë perspektivën ekonomike. Tensionet gjeopolitike, barrierat tregtare dhe ekspozimi ndaj luhatjeve në ekonominë e Eurozonës e bëjnë rajonin të ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme, ndërkohë që normat e interesit mbeten ende të moderuara dhe kërkesa për eksport vazhdon të jetë e dobësuar.

Projeksionet e FMN-së sugjerojnë që rajoni do të shënojë rritje mesatare ekonomike prej 3.4 përqind në vitin 2025, nxitur kryesisht nga konsumi privat, investimet dhe shpenzimet publike. Megjithatë, perspektiva për rritje ekonomike mbetet më e zbehtë krahasuar me parashikimet e mëparshme, ku FMN-ja kishte parashikuar rritje prej 3.6 përqind. Sfidat kryesore për rritjen ekonomike të vendeve të rajonit lidhet me ngadalësimin e

Grafik 1. Rritja ekonomike dhe inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor (TM2 2025)



Burimi: Agjencitë statistikore përkatëse.

aktivitetit ekonomik në Eurozonë, partner kyç tregtar i Ballkanit Perëndimor, me ndikim potencial në eksporte, remitenca dhe flukse të investimeve të huaja direkte. Pasiguri të tjera burojnë nga politika tregtare globale, që mund të ndikojë në zinxhirët e furnizimit, si dhe nga faktorë të brendshëm, përfshirë pasiguritë politike. **Shkalla mesatare e inflacionit në TM2 2025 u përshpejtua në 3.7 përqind (3.3 përqind), kryesisht si rezultat i çmimeve të ushqimit dhe energjisë, ndërkohë që Maqedonia e Veriut shënoi inflacionin më të lartë prej 4.2 përqind ndërsa Shqipëria rezulton të ketë shënuar normën më të ulët të inflacionit prej 2.3 përqind.**


Në TM2 2025, kursi i këmbimit i euros shfaqti luhate të ndryshme ndaj valutave të partnerëve tregtar. Euro u vlerësua ndaj lirës turke dhe dollarit amerikan krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa u zhvlerësua ndaj frangut zviceran, lekut shqiptar dhe sterlinës britaneze. Kursi i euros mbeti pothuajse i pandryshuar ndaj denarit maqedonas.

2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare ishin të favorshme në TM2 2025, me indeksin përkatës të Bankës Botërore që rezultoi me rënie vjetore prej 11.0 përqind. Kjo ecuri reflekton kryesisht rënien e çmimeve të naftës dhe metaleve bazë, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global. Për gjithë vitin 2025, Banka Botërore parashikon një rënie të mëtejme të çmimeve të mallrave bazë, duke arritur në mesatarisht 12.4 përqind. Por, perspektiva minohet nga pasiguri rreth zhvillimeve gjeopolitike, tregtisë globale si dhe nga ecuria e aktivitetit ekonomik global.

Çmimi i naftës së papërpunuar Brent ra në mesatarisht \$67.8 për fuçi në TM2 2025, duke rezultuar me rënie vjetore prej 20.1 përqind dhe tremujore prej 10.4 përqind (grafik 2). Kjo lëvizje u ndikua nga rritja e prodhimit të naftës nga OPEC+, rënia e kërkesës si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global, si dhe pasiguritë rreth perspektivës së tregtisë globale pas vendosjes së tarifave nga SHBA-të. Edhe pse në qershor u evidentuan presione të perkohshme inflacioniste si rezultat i konfliktit të shkurtër Iran–Izrael, në muajt vijues u evidentua lehtësim i presioneve inflacioniste. Në periudhën në vazhdim, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik global dhe rritja e prodhimit nga OPEC+ pritet të ushtrojë presione në kahun rënës. Megjithatë, ecuria e çmimeve të naftës mbetet e cenuar nga rreziqe potenciale si përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike dhe atyre tregtare.


Grafik 2. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Çmimet e gazit natyror në Evropë arritën në \$11.9/mmbtu në TM2 2025, duke shënuar një rritje vjetore prej 18.4 përqind, si pasojë e efektit bazë nga niveli më i ulët i çmimeve në TM2 2024. Sidoqoftë, në terma tremujorë, çmimet e gazit natyror shënuan rënie prej 17.6 përqind në sajë të zbutjes së kërkesës për gaz natyror të lëngshëm (LNG) nga Azia si pasojë e tensioneve tregtare. Deri në gusht, çmimet regjistruan rritje vjetore prej 28.5 përqind, dukshëm mbi projeksionet e Bankës Botërore prej 5.8 përqind për vitin 2025.

Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve shënoi rënie vjetore prej 5.4 përqind dhe 2.5 përqind në terma tremujorë (grafik 3). Rënia u nxit nga perspektiva e zymtë ekonomike globale, tensionet tregtare dhe aktiviteti i dobët në sektorin e ndërtimit në Kinë. Rrjedhimisht, rënie u evidentua në xehen e hekurit dhe metaleve tjera, ndërsa çmimet e kallajit dhe bakrit përbënë përjashtim për shkak të kufizimeve në ofertë dhe kërkesës së lartë nga sektori i energjisë së gjelbër dhe ai i automjeteve elektrike. Sipas Bankës Botërore, çmimet e metaleve dhe mineraleve pritet të shënojnë rënie vjetore prej 9.8 përqind në vitin 2025, të diktuar kryesisht nga ecuria e aktivitetit ekonomik global, me rreziqe potenciale nga goditjet në ofertë dhe tensionet tregtare.

Grafik 3. Indeksi i metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara




Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara shënoi rritje vjetore prej 36.9 përqind (grafik 3), i diktuar nga çmimet rekorde të arit me rritje vjetore prej 41.0 përqind, argjendi 16.8 përqind dhe platini 8.5 përqind. Në terma tremujorë, ky indeks shënoi rritje prej 13.7 përqind, e intensifikuar gjatë konfliktit Iran–Izrael, duke reflektuar qartë ndikimin e tensioneve gjeopolitike si nxitësi kryesor i rritjes së çmimeve të arit dhe argjendit. Ndërsa, rritja e çmimeve të platinut u ndikua nga shqetësimet për kufizime në ofertë dhe kërkesa spekulative në tregje.

Indeksi i çmimeve të ushqimit, sipas FAOs, në TM2 2025 rezultoi me rritje vjetore prej 6.3 përqind, diktuar nga çmimet më të larta të bulmetit, vajrave dhe mishit (grafik 4).

Kundrejt tremujorit paraprak, indeksi shënoi rritje prej 1.3 përqind, me ecurinë e tij që u përcaktua nga rritja e çmimeve të mishit prej 5.3 përqind dhe bulmetit prej 4.8 përqind si rrjedhojë e kërkesës së fortë kundrejt sasisë më të kufizuar për eksport. Në anën tjetër, çmimet e drithërave, vajit dhe sheqerit shënuan rënie në terma tremujorë kryesisht si rezultat i rritjes së rendimentit dhe zbutjes së kërkesës, kurse çmimet e sheqerit u ndikuan shtesë nga

Grafik 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAO.


dhe ndikimi potencial në sektorin e pijeve dhe ushqimit të përpunuar.

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Rritja Ekonomike

Gjatë TM2 2025, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje më të lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV) ishte 4.6 përqind në TM2 2025, krahasuar me 4.3 përqind në TM2 2024 (grafiku 5). Rritja e aktivitetit ekonomik rezultoi të jetë mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme, me konsumin e përgjithshëm që shënoi rritje prej 6.5 përqind dhe investimet që shënuan rritje të lartë prej 11.0 përqind. Kontribut pozitiv në mbështetjen e aktivitetit të përgjithshëm kishte edhe eksporti i shërbimeve që shënoi rritje prej 15.9 përqind. Në anën tjetër, eksporti i mallrave ka pësuar rënie prej 4.5 përqind dhe importi i mallrave ka vijuar të rritet me ritme të larta prej 13.3 përqind në terma real, duke ndikuar negativisht në bilancin tregtar dhe BPV-në përgjithësisht.

Grafik 5. Rritja reale e BPV-së




Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Konsumi privat kontribuoi pozitivisht në rritjen ekonomike, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar, duke shënuar rritje për 3.9 përqind krahasuar me 6.6 përqind në TM2 2024. Remitencat vazhduan të mbështesin konsumin privat, duke shënuar rritje prej 4.1 përqind në TM2 2025, rritje që neutralizoi deri në një masë rënie e kredive të reja konsumuese. Me rritje të lartë prej 25.1 përqind u karakterizua konsumi qeveritar (rënie prej 0.9 përqind në TM2 2024), dinamikë që kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve rrjedhëse. Investimet gjithashtu shënuan rritje të përshpejtuar prej 11.0 përqind (3.0 përqind në TM2 2024), dinamikë e ndikuar kryesisht nga rritja e IHD-ve në sektorin e patundshmërive, rritja e kredive investuese dhe investimeve publike.

Deficiti i eksporteve neto është thelluar më tej gjatë TM2 2025. Eksporti i mallrave shënoi rënie për 4.5 përqind, në kontrast me rritjen prej 10.4 përqind në TM2 2024, kryesisht si pasojë e rënies së eksporteve të metaleve bazë që njëkohësisht kanë edhe pjesëmarrjen më të lartë në strukturën e eksporteve. Ndërkohë, eksporti i shërbimeve shënoi rritje të konsiderueshme prej 15.9 përqind, veçanërisht në sektorin e shërbimeve të udhëtimit kategori që u karakterizua me rritje prej 31.4 përqind. Importi i mallrave shënoi rritje të lartë prej 13.3 përqind, dyfish më shumë se rritja prej 6.1 përqind në TM2 2024, duke reflektuar kryesisht rritjen e kërkesës së brendshme. Importi i shërbimeve gjithashtu u rrit, por me ritëm më të ngadaltë prej 13.0 përqind, krahasuar me 17.4 përqind në TM2 2024.

Grafik 6. Numri i ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK.

Aktiviteti ekonomik gjatë TM2 2025 rezultoi të jetë mbështetur nga sektori i ndërtimtarisë, që shënoi rritje prej 4.1 përqind, tregtisë dhe industrisë përpunuese, që u karakterizuan me rritje prej 3.8 përqind krahasuar me 3.3 përqind, dhe shërbimet financiare

dhe të sigurimit që shënuan rritje prej 8.8 përqind. Në anën tjetër, sektori i energjisë elektrike vazhdoi me rënie të theksuar prej 37.2 përqind, duke ndikuar negativisht në dinamikën e përgjithshme ekonomike.

Aktiviteti ekonomik u pasqyrua edhe në dinamikën e regjistrimit të ndërmarrjeve të reja. Në TM2 2025 janë regjistruar 3,627 ndërmarrje të reja, apo 28.8 përqind më shumë se në TM2 2024. Ndërkohë, janë shuar 349 ndërmarrje, apo 1.6 përqind më pak se gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Sektorët me ndikim më të madh në këtë periudhë ishin tregtia, prodhimi, hoteleria dhe aktivitetet profesionale.

Në përgjithësi, TM2 2025 u karakterizua nga një rritje ekonomike e qëndrueshme, e mbështetur nga konsumi publik, investimet dhe rritja e eksportit të shërbimeve. Megjithatë, bilanci tregtar mbetet sfidë e rëndësishme, për shkak të thellimit të deficitit të shkaktuar nga rënia e eksportit të mallrave dhe rritja e importit. Për gjithë vitin 2025, projeksionet e fundit të BQK-së sugjerojnë se ekonomia do të rritet me 3.9 përqind, me kontribuues kryesor konsumin, investimet dhe eksportin, ndërsa importi pritet të ndikoj negativisht në rritjen ekonomike.


3.2. Çmimet

Inflacioni në TM2 2025 u përshpejtua në 3.7 përqind, nga 2.0 përqind në tremujorin paraprak, i nxitur nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe shërbimeve, dhe në shkallë më të ulët nga rritja e çmimeve të mallrave tjera. Në anën tjetër, rënia e çmimeve të naftës vijoi të kontribuojë në zbutjen e inflacionit. Ecuri rritëse u evidentua edhe në inflacionin bazë, i diktuar kryesisht nga rritja e çmimeve të shërbimeve.

Rritja vjetore e çmimeve të ushqimit u përshpejtua ndjeshëm në 8.0 përqind në TM2 2025, nga 4.2 përqind në tremujorin paraprak. Kjo rritje pasqyron transmetimin e zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare përmes kanalit të importit, ku sipas indeksit të çmimeve të importit, çmimet e produkteve shtazore dhe bimore të importuara u rritën për 7.2 dhe 3.8 përqind përkatësisht. Rrjedhimisht, në tregun vendor rritja më e lartë u evidentua në çmimet e frutave prej 12.9 përqind, mishit (11.5 përqind), vajrave ushqimore (10.6 përqind), perimeve (7.8 përqind) dhe bulmetit (6.6 përqind) (grafiku 7). Megjithatë, për kategorinë e vajrave ushqimore, indeksi i çmimeve të importit shënoi rënie vjetore prej 8.3 përqind, duke sugjeruar se rritja e çmimeve në tregun vendor është ndikuar edhe nga kostot e brendshme të përpunimit dhe operimit, siç mund të kuptohet nga rritja e indeksit të çmimeve të prodhimit (IÇP).

Çmimet e karburanteve shënuan rënie vjetore prej 7.8 përqind. Pas një rritjeje tremujore në TM1 2025, ato ranë për 5.4 përqind në TM2 në terma tremujorë, duke reflektuar zhvillimet në tregjet ndërkombëtare në kohë reale. Rritja e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare në qershor u reflektua edhe në tregun vendor, por u zbut shpejt në muajt pasues. Në anën tjetër, çmimet e energjisë elektrike u rritën për 12.1 përqind për shkak të tarifave më të larta të miratuara nga ZRRE. Kurse, çmimet e lëndëve tjera djegëse shënuan rënie prej 4.7 përqind, si rrjedhojë e rritjes së përdorimit të mjeteve alternative për ngrohje.


Grafik 7. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit në TM2 2025 u rrit në 2.1 pikë përqindje kundrejt 1.1 p.p. në tremujorin paraprak. Kontribuuesit kryesor në inflacionin e ushqimit ishin rritja e çmimeve të mishit me 0.8 p.p., bulmetit me 0.4 p.p., frutave dhe perimeve me 0.6 p.p. Kontributi i energjisë mbeti negativ i dominuar nga rënia e çmimeve të naftës. Megjithatë, ai u tkurr për 0.1 p.p., ndikuar nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike. Kontributi i mallrave të tjera mbeti pothuajse i pandryshuar, me zgjerim vetëm 1.0 p.p. Ndërsa, kontributi i shërbimeve në inflacion u rrit në 0.7 p.p., nga 0.3 p.p. në TM1, për shkak të rritjes së çmimeve të restoranteve, transportit, shërbimeve ambulatore, pakove turistike dhe kujdesit personal.

Grafik 8. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Rritja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në inflacionin bazë, që rezultoi 2.0 përqind në TM2 2025. Megjithëse çmimet e ushqimit përjashtohen nga ky indeks, efekti i tyre u evidentua përmes rritjes së çmimeve të shërbimeve të gastronomisë që ishin kontribuuesi kryesor në inflacionin bazë me 0.7 p.p. Ecuria rritëse e inflacionit bazë po ashtu reflekton rritjen e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve për kujdes personal dhe atyre për mirëmbajtjen e vendbanimit, dhe në shkallë më të ulët rritjen e çmimeve të shërbimeve rekreative dhe veshmbathjes. Në anën tjetër, efekt në zbutjen e inflacionit bazë kishin rënia e çmimeve të blerjes së veturave dhe mjeteve të komunikimit (grafiku 8).

Origjina e presioneve inflacioniste në TM2 2025 pasqyron një kombinim të faktorëve nxitës të jashtëm dhe të brendshëm. Ushqimi mbeti nxitësi kryesor i inflacionit, dhe varësia nga importet e ushqimit, ndikoi që rritja e çmimeve të reflektohet në rritje të inflacionit të importuar në 2.9 p.p. Paralelisht, rritja e çmimeve të shërbimeve kontribuoi në zgjerimin e inflacionit të brendshëm në 0.8 p.p.

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) shënoi rritje vjetore prej 0.7 përqind. Rritja ishte më e theksuar në çmimet e produkteve shtazore (7.2 përqind) dhe atyre bimore (3.8 përqind). Çmimet e ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit shënuan rritje prej 1.9 përqind. Në anën tjetër, dobësimi i kërkesës globale u reflektua në rënie të çmimeve të metaleve bazë (0.3 përqind) dhe produkteve minerale (3.4 përqind).

Rritja ishte më e dukshme në indeksin e çmimeve të prodhimit në vend (IÇP) i cili shënoi rritje vjetore prej 11.3 përqind. Nxitësit kryesor rezultuan të kenë qenë çmimet e prodhimit të energjisë elektrike me rritje vjetore prej 39.7 përqind, përpunimi i produkteve ushqimore me rritje prej 2.7 përqind, prodhimi i drurit dhe mobileve me rritje prej 4.3 dhe 13.0 përqind respektivisht. Ndërsa, rënie e çmimeve u evidentua në prodhimin e metaleve prej 8.1 përqind, produkteve minerale jo metalike prej 0.4 përqind, dhe pijeve prej 0.3 përqind, të ndikuara nga dinamikat në çmimet e metaleve, naftës dhe sheqerit në tregjet ndërkombëtare.

Indeksi i kostos së ndërtimit (IKN) rezultoi me rritje vjetore prej 4.0 përqind. Ecuria e tij u përcaktua kryesisht nga çmimet e materialeve ndërtimore që përbëjnë 60.4 përqind të këtij indeksi, dhe që shënuan rritje vjetore prej 3.5 përqind. Pagat, po ashtu, vijuan të ushtrojnë presione inflacioniste në këtë sektor, krahas energjisë elektrike, transportit dhe kostove tjera.

Sipas parashikimeve të BQK-së, norma mesatare e inflacionit për vitin 2025 pritet të sillet rreth 3.8 përqind. Ecuria e inflacionit pritet të vijojë të përcaktohet nga presionet inflacioniste në çmimet e ushqimit, megjithëse efekti bazë mund ta neutralizojë paksa ndikimin. Rreziqet kryesore ndaj këtij projekcioni lidhen me

goditjet potenciale në ofertën e mallrave ushqimore dhe atyre energjetike në rast të përshkallëzimit të tensioneve gjeopolitike dhe kushteve klimatike, si dhe me ecurinë e kërkesës globale.

3.3 Sektori Fiskal


Sektori fiskal shënoi rritje të përshpejtuar gjatë TM2 2025, si në të hyra ashtu edhe në shpenzime. Të hyrat primare buxhetore¹ arritën vlerën neto prej 866.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 16.9 përqind. Shpenzimet buxhetore² po ashtu shënuan rritje të shpejtë prej 15.5 përqind, duke arritur në 761.4 milionë euro. Përkundër rritjes së shpenzimeve, niveli më i lartë i të hyrave rezultoi në suficit primar buxhetor prej 118.2 milionë euro.

Të hyrat tatimore në TM2 2025 arritën në 766.4 milionë euro, duke shënuar rritje të konsiderueshme prej 18.1 përqind krahasuar me TM2 2024. Gjatë kësaj periudhe, dy kategoritë kryesore të të hyrave, ato nga tatimet direkte dhe ato indirekte, patën trend pozitiv. Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej 10.7 përqind, duke arritur në 160.6 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave shënuan rritje prej 13.4 përqind, ato nga tatimi në të ardhurat personale u rritën me 3.8 përqind, ndërsa tatimi në pronë pati rritje të lartë prej 39.8 përqind.

Tatimet indirekte, që përbëjnë 72.5 përqind të të hyrave tatimore, shënuan rritje prej 20.2 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Brenda kësaj kategorie, mbizotërojnë të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, të cilat shënuan rritje prej 17.6 përqind, duke arritur në 413.6 milionë euro. Kjo rritje u mbështet kryesisht nga rritja nominale e importit prej 14.4 përqind, si dhe nga rritja nominale e konsumit të përgjithshëm prej 8.2 përqind. Pas saj janë të hyrat nga akciza, të cilat shënuan rritje më të lartë prej 29.6 përqind, duke arritur në 166.4 milionë euro. Kjo rritje u ndikua si nga shtimi i sasisë së importuar për TM2 2025 me 12.1 përqind, ashtu edhe nga rritja e çmimeve dhe përpjekjet e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për të luftuar informalitetin. Si rezultat, ATK ka raportuar 71.2 milionë euro më shumë të hyra për periudhën janar-gusht 2025, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Po ashtu, të hyrat nga detyrimi doganor shënuan rritje prej 13.4 përqind dhe arritën vlerën 46.4 milionë euro (grafik 9).

Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje më të ngadalësuar prej 9.0 përqind, duke arritur në 96.7 milionë euro. Kjo kategori përfshinë të hyrat nga qeveria qendrore, të cilat shënuan rënie prej 21.4 përqind, duke arritur në 45.6 milionë euro, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje për 19.1 përqind, duke arritur në 19.1 milionë euro.

Grafik 09. Të hyrat tatimore sipas kategorive, në milionë euro




Burimi: MFPT.

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga huazimet shtetërore.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat për financim.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 11.9 përqind. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për subvencione dhe transfere, si kategoria kryesore, shënuan rritje prej 23.6 përqind, duke arritur vlerën 258.8 milionë euro. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 17.1 përqind, dhe arritën në 121.3 milionë euro. Shpenzimet për paga shënuan rënie prej 2.6 përqind, duke arritur në 221.1 milionë euro. Shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 33.3% përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar duke arritur në 145.5 milionë euro (grafik 10).

Grafik 10. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: MFPT.


Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u rrit në 16.0 përqind në TM2 2025, krahasuar me 15.8 përqind në TM2 2024. Kjo rritje e lehtë e raportit të borxhit publik ishte rezultat i rritjes së borxhit të jashtëm, ndërsa borxhi i brendshëm u zvogëlua. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.77 miliardë euro në TM2 2025, duke shënuar rritje prej 6.3 përqind krahasuar me TM2 2024. Borxhi i jashtëm publik u rrit për 20.6 përqind, duke arritur vlerën 851.6 milionë euro. Ndërkohë, borxhi i brendshëm publik u zvogëlua për 4.2 përqind, duke arritur në 916.2 milionë euro.

Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrime financiare ndaj institucioneve ndërkombëtare, si Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (me 31 përqind të borxhit të jashtëm), Fondi Monetar Ndërkombëtar (20 përqind) Bashkimi Evropian (12 përqind), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (9 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i brendshëm publik përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës (letrat me vlerë) ndaj fondeve pensionale (45 përqind), bankave komerciale (23 përqind), institucioneve publike (23 përqind), etj.

3.4. Sektori i jashtëm

Në TM2 2025, deficitin e llogarisë rrjedhëse u thellua për 35.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke arritur në 461.5 milionë euro. Ky zhvillim është i lidhur kryesisht me rritjen e deficitit tregtar të mallrave, i cili mbetet komponenti përcaktues i llogarisë rrjedhëse. Rritja më e shpejtë e importit krahasuar me eksportin ka ndikuar negativisht në këtë zhvillim. Megjithatë, ky efekt negativ u neutralizua pjesërisht nga përmirësimi i bilancit të shërbimeve, me kontribut të veçantë nga shërbimet e udhëtimit, por dhe nga bilanci pozitiv i të ardhurave parësore dhe dytësore (grafik 11).

Grafik 11. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK.


Deficiti tregtar i mallrave u thellua me 16.6 përqind, duke arritur në 1.5 miliardë euro (grafik 12). Ky përkeqësim pasqyron kryesisht zgjerimin e mëtejshëm të importit, duke arritur në 1.7 miliardë euro, nxitur nga rritja e kërkesës në vend. Në anën tjetër, eksporti mbeti në nivel të ulët, me vlerë prej vetëm 235.6 milionë euro, duke mbuluar vetëm 13.5 përqind të importit. Ky raport i dobët tregon për varësinë e lartë të ekonomisë nga importi dhe për kapacitetet e kufizuara eksportues. Kjo asimetri jo vetëm që rëndon bilancin tregtar, por gjithashtu thellon varësinë e kërkesës së brendshme nga tregjet e jashtme, duke ekspozuar ekonominë ndaj luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare dhe rreziqeve të jashtme.

Grafik 12. Bilanci tregtar i mallrave




Eksporti i mallrave shënoi rritje modeste prej 1.4 përqind, e cila u kufizua kryesisht nga performanca e dobët e disa kategorive kryesore, veçanërisht metaleve bazë, të cilat shënuan rënie për 7.2 përqind (grafik 13). Tkurrrja e përgjithshme e eksportit të metaleve bazë prej -4.2 milionë euro në TM2 2025, u përcaktua kryesisht nga rënia e eksportit të metaleve ferro nikel prej 3.1 milionë euro, dhe në të njëjtën kohë u ndikua edhe nga rënia e kërkesës së jashtme për metale si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global. Produktet minerale regjistruan rënie prej 12.7 përqind, duke kontribuar me -0.9 pikë përqindje në rënie të gjithsej eksportit. Megjithatë, disa kategori të tjera kontribuan pozitivisht dhe zbutën këtë efekt negativ. Eksporti i produkteve të plastikës, përfshirë gomën, si dhe artikujt ushqimorë, shënuan rritje dhe ofruan mbështetje për performancën e përgjithshme të eksportit të mallrave. Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor, me 44.7 përqind të gjithsej eksporteve, ku Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë destinacionet kryesore. Vendet e BE-së përbënin 34.7 përqind të gjithsej eksportit, me destinacionin kryesor Gjermaninë.

Garfik 13. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Garfik 14. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Importi i mallrave shënoi rritje dyshifrore prej 14.3 përqind, duke arritur në 1.7 miliardë euro (grafik 14). Kjo rritje është nxitur kryesisht nga rritja e sasisë së mallrave të importuara që pasqyron rritje të kërkesës në vend. Rritja ishte e përqendruar kryesisht në mallrat konsumuese të cilat shënuan rritje për 17.3 përqind, pastaj mallrat kapitale 16.2 përqind dhe mallrat e ndërmjetme 11.2 përqind, duke reflektuar kombinim të konsumit të lartë dhe investimeve në rritje. Kategori të veçanta si automjetet kontribuan ndjeshëm në këtë


rritje (2.5 pikë përqindje), sidomos për shkak të uljes së tarifave doganore prej 25.0 përqind për automjetet nga Koreja e Jugut. Po ashtu, importi i makinerive dhe pajisjeve elektrike kontribuoj me 2.5 pikë përqindje, mbështetur nga kërkesa në rritje për pajisjet më efikase të energjisë, ndërsa importi i artikujve ushqimorë kontribuoj me 2.2 pikë përqindje, i ndikuar nga kërkesa e qëndrueshme për konsum. Gjeografikisht, importi i mallrave nga BE përfaqëson 43.0 përqind të gjithëj importit, ndërsa Turqia dhe vendet e rajonit po fitojnë gjithnjë e më shumë terren, me 13.7 përkatësisht 13.0 përqind, gjë që sugjeron për një proces të vazhdueshëm diversifikimi, i cili mund të nxisë konkurrencë më të madhe dhe ulje të kostove për importuesit vendas.

Bilanci i shërbimeve shënoi përmirësim të ndjeshëm, duke arritur në 363.1 milionë euro, me rritje vjetore prej 26.8 përqind. Kjo u mundësua kryesisht nga rritja e eksportit të shërbimeve me 20.0 përqind, në veçanti shërbimet e udhëtimit (+31.4 përqind) dhe ato të teknologjisë së informacionit, kompjuterike dhe telekomunikacionit (+19.5 përqind). Eksporti i shërbimeve arriti në 771.0 milionë euro, ndërsa importi në 407.9 milionë euro (+14.5 përqind). Rritja më e lartë e eksportit bëri që bilanci të jetë pozitiv (grafik 15). Veçanërisht, roli i diasporës është thelbësor në rritjen e shërbimeve të udhëtimit, por vëmendje të veçantë po marrin edhe shërbimet e teknologjisë, të cilat po kontribuojnë në transformimin gradual të strukturës së ekonomisë dhe në zgjerimin e bazës eksportuese.

Bilanci i të ardhurave parësore arriti vlerën prej 45.8 milionë euro, duke shënuar rritje të lehtë prej 2.3 përqind (grafik 16). Kompensimi i punëtorëve ka kontribuar ndjeshëm në këtë përmirësim, me rritje vjetore prej 15.3 përqind, duke arritur në 117.1 milionë euro. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave nga investimet vazhdoi të mbetet negativ, duke shënuar vlerën prej 70.8 milionë euro, kryesisht per shkak të fitimit të rinvestuar nga investitorët e huaj.


Remitancat vazhduan trendin e rritjes edhe në TM2 2025, duke shënuar rritje vjetore prej 4.1 përqind dhe arritën vlerën prej 363.4 milionë euro, ritëm më i përsheptuar krahasuar me tremujorin paraprak (grafik 17). Struktura e kanaleve të dërgimit tregon zhvendosje të dukshme: remitencat përmes bankave dhe agjencive per transfer të mjeteve shënuan rënie të lehtë prej 0.9 përqind, ndërsa remitencat përmes kanaleve të tjera u rritën ndjeshëm me 19.2 përqind, zhvillim që u mbështet nga fluksi më i madh i vizitave të diasporës gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, kanalet formale ende mbesin dominuse në vlerën e përgjithshme me 71.4 përqind të remitencave ndërsa pjesa tjetër vazhdon të realizohet përmes kanaleve joformale. Nga aspekti gjeografik, Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave (56.5 përqind të totalit), ndjekur nga SHBA-të dhe vendet e tjera të BE-së. Kjo strukturë tregon për bazë të qëndrueshme, ku pjesa

Grafik 15. Bilanci i shërbimeve



Burimi: BQK.


Grafik 16. Bilanci i të ardhurave parësore



Burimi: BQK.


kryesore buron nga diaspora e vendosur në vendet e Evropës, duke sugjeruar se remitancat mbeten një burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe konsumit në vend.

Grafik 17. Remitencat



Burimi: BQK.

Grafik 18. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

IHD-të arritën në 231.5 milionë euro në TM2 2025, duke shënuar rritje vjetore prej 32.1 përqind (grafik 18). Këto investime u përqendruan kryesisht në sektorin e patundshmërisë (80.8 përqind), kryesisht nga kërkesa e diasporës dhe rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme në vend. Ndërkohë, sektorët e tjerë, si ai financiar, energji dhe xehetari shënuan tkurrje të aktivitetit, duke evidentuar mungesë të diversifikimit të investimeve të huaja dhe rrezikun e përqendrimit të lartë në sektorin e patundshmërisë. Në anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit shënuan rritje të dukshme prej 34.0 përqind, megjithëse me ritëm më të ngadaltë se tremujori paraprak. Vlera e këtyre investimeve në TM2 2025 arriti në 93.8 milionë euro, kryesisht si investime në sektorin e patundshmërisë.

4. Sistemi financiar


Në tremujorin e dytë të vitit 2025, sistemi financiar në vend shënoi rritje vjetore të përshpejtuar, pas ngadalësimit të regjistruar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlera e aseteve të sistemit financiar në fund të periudhës arriti në 13.11 miliardë euro - rritje prej 14.6 përqind nga 12.3 përqind në vitin paraprak (grafik 19). Dinamika e zhvillimeve sipas sektorëve mbeti e njëjtë nga tremujori i kaluar; sektori bankar dhe ndihmësit financiar u karakterizuan me rritje vjetore të përshpejtuar, ndërsa sektori i fondeve pensionale, sigurimeve dhe ai mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore nga qershori i vitit të kaluar.

Kontributin kryesor në zgjerimin e sistemit financiar e kishte sektori bankar, i cili vazhdon të jetë sektori me peshën më të madhe, duke përfaqësuar 66.3 përqind të total aseteve të sistemit në qershor 2025 (grafik 20). Fondet pensionale dhe sektori i sigurimeve shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar, përkatësisht prej 15.0 përqind dhe 6.3 përqind, krahasuar me 15.8 përqind dhe 12.2 përqind në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Megjithatë, për shkak të rritjes dukshëm më të ulët në sektorin e sigurimeve, fondet pensionale shënuan një rritje të lehtë të pjesëmarrjes në sistemin financiar, duke arritur në 25.8 përqind apo rritje vjetore për 0.1 pikë përqindje. Ndërsa, pjesëmarrja e sektorit të sigurimeve zbriti në 2.7 përqind nga 2.9 përqind në qershor të vitit paraprak. Sektori mikrofinanciar dhe ai financiar jo-bankar, megjithëse shënuan ngadalësim të rritjes vjetore në 18.2 përqind nga 28.7 përqind, regjistruan një rritje të lehtë të pjesëmarrjes në sistem, duke arritur në 5.1 përqind nga 5.0 përqind. Ndërkohë, sektori i ndihmësve financiar ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 21.8 përqind, pas rënies së theksuar prej 60.7 përqind në vitin e kaluar që ishte pasojë e riklasifikimit të dy operatorëve nga ndihmës financiarë në IMF/IFJB. Megjithatë, për shkak të peshës së ulët në sistemin financiar, kontributi i këtij sektori në rritjen e përgjithshme vazhdoi të jetë minimal.

4.1. Sektori bankar


Asetet e sektorit bankar arritën në 8.69 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 14.5 përqind nga 10.3 përqind në qershor të vitit paraprak (grafiku 21). Ky zhvillim është mbështetur kryesisht nga rritja e lartë vjetore e kreditimit, i cili përfaqëson 73.4 përqind të gjithsej vlerës së aseteve të sektorit bankar. Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, si kategoria e dytë më e rëndësishme në kuadër të aseteve, ka shënuar rritje prej 12.4 përqind nga 8.1 përqind një vit më parë. Ndërsa, letrat me vlerë dhe bilanci me bankat komerciale u karakterizuan me rënie, kryesisht si rezultat i riorientimit strategjik të mjeteve drejt rritjes së

Grafik 19. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK.

Grafik 20. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Burimi: BQK.


kreditimit. Më konkretisht, letrat me vlerë shënuan rënie prej 1.1 përqind, kjo si rezultat i rënies së investimeve në letra me vlerë të huaja me 3.9 përqind. Megjithatë, kjo rënie u zbut pjesërisht nga rritja e investimeve në letra me vlerë vendore me 7.6 përqind. Ndërkohë, bilanci me bankat komerciale ka shënuar rënie për vitin e dytë me radhë, apo rënie prej 11.9 përqind nga 21.9 përqind një vit më parë.

Stoku i gjithsej kredive arriti në 6.38 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 19.3 përqind nga 13.4 përqind në qershor 2024. Megjithatë, krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti, aktiviteti kreditues i sektorit bankar ka ngadalësuar lehtësisht ritmin e rritjes (grafik 22). Kredië e reja investive ndaj korporatave jofinanciare, si dhe kreditë hipotekare ndaj ekonomive familjare shënuan rënie krahasuar me tremujorin paraprak, në të cilin shënuan rritje të lartë.

Sipas Anketës së Kreditimit Bankar për TM2 2025, ngadalësimi i rritjes gjatë këtij tremujori reflekton shtrëngimin e ofertës kreditore deri në një masë, si për ekonomitë familjare ashtu edhe për korporatat jofinanciare. Oferta kreditore u shtrëngua për ekonomitë familjare në përgjithësi, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë konsumuese. Në kuadër të ndërmarrjeve, shtrëngimi ishte më i theksuar tek ndërmarrjet e mëdha. Niveli i aprovimit të kredive u rrit lehtësisht për të dy sektorët, si për ndërmarrjet edhe për ekonomitë familjare, mirëpo në shkallë më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Sa i përket kushteve dhe rregullave për ndërmarrjet, u deklarua për lëvizje në drejtime të ndryshme, por me prirje të përgjithshme drejt shtrëngimit, duke përfshirë edhe normat e interesit për kredi të reja në sektor të caktuar. Për ekonomitë familjare, krahas shtrëngimit në normë të interesit në produkte të caktuara, u deklarua gjithashtu për shtrëngim, por në masë më të ulët, në madhësinë mesatare të kredisë, kërkesat për kolateral dhe pagesat tjera përveç normës së interesit.


Kërkesa për kredi u rrit në të dy sektorët, ndonëse në një nivel më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Faktorët kryesorë që ndikuan kërkesën kreditore ishin financimi i inventarëve dhe kapitalit punues për ndërmarrjet, ndërsa për ekonomitë familjare ndikuan shpenzimet e konsumit dhe besueshmëria e konsumatorëve. Në TM3 2025, oferta kreditore pritet të mbetet e pandryshuar për ndërmarrjet në përgjithësi, me tendencë shtrënguese për ndërmarrjet e mëdha. Për ekonomitë familjare, pritet shtrëngim marginal i ofertës në përgjithësi. Sa i përket kërkesës për kredi, pritet të përshpejtohet për NVM-të, ndërsa nga ndërmarrjet e mëdha pritet rënie e kërkesës. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare pritet të mbetet e pandryshuar, si për kreditë konsumuese ashtu edhe për ato për blerje të shtëpive.

Grafik 21. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet



Burimi: BQK.

Grafik 22. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Zgjerimi i portofolios kreditore në sektorin bankar u ndikua në masë më të madhe nga dinamika e kredive të korporatave jo-financiare, për shkak të peshës më të lartë të këtij segmenti (58.0% të totalit të kredive). Megjithatë, pjesëmarrja e tij ka shënuar ulje të lehtë prej 1.4 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, reflektim i ritmit më të shpejtë të rritjes së kreditimit për ekonomitë familjare, veçanërisht të kredive hipotekare me afat më të gjatë maturimi. Ky zhvillim tregon një ndryshim gradual në strukturën e portofolit, duke reflektuar orientimin e tregut drejt zgjerimit të kreditimit për individët dhe pasuritë e paluajtshme.

Krahas rritjes së vlerës së kredive, numri i kredimarrësve ka vazhduar rritjen e përsheptuar vjetore, çka sinjalizon thellim të mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar. Sipas Regjistrimit të Kredive, numri i kredimarrësve të rinj për periudhën janar - qershor 2025 arriti në 13,019 individë, duke shënuar rritje prej 12.4 përqind nga 4.7 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.³


Stoku i kredive të korporatave jo-financiare në qershor 2025 u karakterizua me rritje të lartë vjetore, të ndikuar nga rritja e lartë e kredive të reja në gjysmën e dytë të vitit 2024 si dhe në tremujorin e parë të vitit 2025. Por, në tremujorin e dytë të vitit 2025, kreditë e reja ndryshuan kahjen dhe shënuan rënie prej 15.9 përqind krahasuar me tremujorin paraprak. Vlera e gjithsej stokut të kredive për KJF-të arriti në 3.70 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 16.5 përqind nga 9.5 përqind në vitin paraprak. Kreditë e reja të lëshuara në gjysmën e parë të vitit për KJF-të shënuan rritje vjetore prej 24.9 përqind kundrejt rënies prej 1.8 përqind në vitin e kaluar. Më konkretisht, me rritje u karakterizuan kreditë e reja investive, apo rritje prej 42.4 përqind nga vetëm 4.6 përqind në vitin e kaluar. Ndërsa, kreditë e reja jo-investive, shënuan rënie prej 0.2 përqind krahasuar me rënien prej 13.9 përqind në vitin e kaluar. Por, kreditë e reja të

Grafik 23. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje




Burimi: BQK.

Grafik 24. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 25. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

³ Numri i kredimarrësve të rinj në databazën e Regjistrimit të Kredive të Kosovës.


lëshuara vetëm në tremujorin e dytë shënuan rënie kundrejt tremujorit të parë të vitit, si rezultat i rënies së kredive investive me 12.4 përqind dhe atyre jo investive me 18.1 përqind, duke sinjalizuar ngadalësim të aktivitetit kreditues.

Aktiviteti kreditues i KJF-ve sipas sektorëve ekonomik vazhdon të dominohet nga tregtia, e cila ka shënuar rritje vjetore të kredive me 16.8 përqind nga 10.4 përqind në vitin paraprak dhe përfaqëson 42.3 përqind të gjithsej portfolios (grafik 23). Prodhimi, si kategoria e dytë për nga kontributi në rritjen e gjithsej kredive ndaj KJF-ve ka shënuar rritje të përshpejtuar prej 19.7 përqind nga 1.5 përqind në vitin paraprak (grafik 24). Me rritje të përshpejtuar u karakterizuan edhe shërbimet financiare dhe ndërtimtaria, duke shënuar rritje prej 30.4 përqind dhe 12.3 përqind, nga 12.9 përqind dhe 11.3 përqind, përkatësisht. Mirëpo, pavarësisht zgjerimit më të shpejtë të kreditimit në këta sektor, të dhënat e ATK-së evidentojnë një ngadalësim të rritjes së qarkullimit në sektorët si tregtia, shërbimet financiare dhe ndërtimtaria, dhe rënie të qarkullimit për sektorin e prodhimit.

Stoku i kredive për ekonomitë familjare arriti në 2.61 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 22.8 përqind nga 19.4 përqind në vitin paraprak. Kjo dinamikë në stokun e kredive u ndikua nga rritja e lartë e kredive të reja hipotekare në tremujorin e parë të vitit, ndërsa në tremujorin e dytë aktiviteti kreditor në gjithsej kreditë e reja shënoi ngadalësim. Kreditë e reja hipotekare në gjysmën e parë të vitit u rritën me 56.2 përqind në krahasim me 16.8 përqind një vit më parë (grafik 26). Ndërsa, kreditë e reja konsumuese shënuan rritje dukshëm më të ngadalësuar prej 0.7 përqind nga 44.2 përqind në vitin paraprak. Megjithatë, dinamika e rritjes së kredive të reja ka ndryshuar gjatë tremujorit të dytë të vitit. Gjithsej kredi e reja të lëshuara në këtë tremujor shënuan rënie vjetore si dhe rënie në krahasim me kreditë e lëshuara në TM1. Kreditë e reja hipotekare u karakterizuan me rënie prej 17.6 përqind krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti, ndërsa kreditë e reja konsumuese shënuan rritje prej 4.4 përqind nga tremujori paraprak.


Rritja e lartë vjetore e kredive hipotekare është reflektuar edhe në strukturën e maturimit të stokut të kredive për ekonomitë familjare, duke shënuar rritje të kredive me afate më të gjata. Konkretisht, kategoria ‘mbi 10 vite’ ka zgjeruar pjesëmarrjen në 37.7 përqind, për 2.2 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë. Sipas të dhënave nga databaza e Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK), vlera mesatare e kredive të reja në gjysmën e parë të vitit ka shënuar rritje në 7.3 mijë euro, krahasuar me 6.8 mijë euro në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Po ashtu, afati mesatar i maturimit ka shënuar rritje të lehtë, duke arritur në 3.67 vite, krahasuar me 3.58 vite, një vit më parë (grafik 26a dhe 26b).

Grafik 26. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 26a. Kreditë e reja të EF sipas vlerës së disbursuar në RKK (%)



Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.


26b. Kreditë e reja të EF sipas maturitetit në RKK (%)



Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.


Mirëpo, në tremujorin e dytë është vërejtur një ndryshim, me rritje të numrit të kredive të reja, por në shumica më të ulëta dhe me maturitet më të shkurtër, krahasuar me tremujorin e parë. Konkretisht, krahasuar vetëm tremujorin e dytë me tremujorin e parë të vitit 2025, shumica e disbursuar e kredive të reja është rritur në kategoritë me afat maturimi 1 deri në 5 vite. Ndërsa, numri i kredive të reja është rritur në kategorinë e kredive me afat maturimi deri në 3 vite në tremujorin e dytë, krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti.

Grafik 27. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.


Grafik 27 a. Diferenca (mil. €) dhe ndryshimi i vlerës (%) së depozitave në kuartale



Burimi: BQK.

Stoku i depozitave në sektorin bankar arriti në 6.90 miliardë euro në qershor 2025, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 12.5 përqind nga 9.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 27). Ndërsa, vlera e depozitave në tremujorin e dytë krahasuar me tremujorin paraprak shënoi rënie prej 1.0 përqind (grafik 27a). Depozitat e ekonomive familjare dhanë kontributin kryesor në rritjen vjetore të stokut të gjithsej depozitave, kjo falë ritmit të përshpejtuar të rritjes dhe peshës prej 67.1 përqind në kuadër të gjithsej depozitave. Në qershor 2025, stoku i depozitave të ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 12.5 përqind nga 8.2 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, depozitat e korporatave jo-financiare dhe të korporatave të tjera financiare shënuan rritje të konsiderueshme, përkatësisht prej 13.8 përqind dhe 29.3

Grafik 28. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje




Burimi: BQK.

përqind, krahasuar me 10.5 përqind dhe 10.8 përqind në qershor të vitit të kaluar (grafik 28). Në anën tjetër, depozitat e korporatave publike shënuan rënie vjetore prej 19.9 përqind, pas rritjes prej 28.9 përqind një vit më parë. Rënia e depozitave të korporatave publike është ndikuar kryesisht nga depozitorët e mëdhenj, me theks të veçantë nga sektori i energjisë. Ndërsa, rënia e vlerës së depozitave në TM2 kundrejt TM1 shënoi rënie, kryesisht si rezultat i rënies së depozitave të transferueshme dhe atyre të kursimit nga ekonomitë familjare, korporatat jo-financiare dhe korporatat publike nga tremujori i kaluar. Në qershor 2025, depozitat përbënin 79.3 përqind të gjithë detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit bankar, duke shënuar rënie vjetore për 1.4 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rritjes së bilancit nga bankat komerciale dhe rritjes së burimeve vetanake.

Depozitat e reja, që përfshijnë vetëm depozitat e afatizuara, vijuan trendin e rritjes së ngadalësuar nga tremujori paraprak, ndikuar kryesisht nga efekti i bazës së lartë të vitit të kaluar. Vlera e depozitave të reja për periudhën janar - qershor arriti në 581.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 36.4 përqind nga 49.6 përqind një vit më parë. Segmenti i ekonomive familjare ka shënuar rritje vjetore prej 42.4 përqind nga 51.0 përqind në qershorin e vitit të kaluar dhe mbetet kontribuuesi kryesor në rritjen e gjithë depozitave të reja. Po ashtu, depozitat e reja të korporatave jo-financiare shënuan rritje të ngadalësuar prej 23.6 përqind nga 46.9 përqind në vitin e kaluar (grafiku 29).


Grafik 29. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kredi shënoi rritje si në raport me tremujorin e kaluar, ashtu edhe krahasuar me qershorin e vitit paraprak. Në anën tjetër, norma e interesit në depozita ka shënuar rënie për periudhat e njëjta krahasuese. Në qershor 2025, norma e interesit në kredi arriti në 6.3 përqind, krahasuar me 5.7 përqind në mars 2025, ndërsa nga qershori 2024 ka shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje. Rritja e normës së interesit në kredi korrespondon me rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë, e cila evidenton një shtrëngim të kushteve të financimit, përfshirë normat e interesit, si pasojë e përshpejtimit më të madh të kreditimit në tremujorin paraprak krahasuar me rritjen e depozitave. Ndërsa, norma e interesit në depozita ka shënuar një rënie të lehtë, duke zbritur në 2.7 përqind në qershor 2025 — përkatësisht 0.2 pikë përqindje më pak se në mars 2025 dhe 0.1 pikë përqindje më pak krahasuar me qershorin e vitit paraprak. Si pasojë, diferenca ndërmjet normës së interesit në kredi dhe në depozita është zgjeruar sërish, duke arritur në 3.6 pikë përqindje nga 3.2 pikë përqindje një vit më parë. Po ashtu, krahasuar me marsin 2025, ky hendek ka shënuar rritje për 0.8 pikë përqindje, si rezultat i zvogëlimit të normës së interesit në depozita dhe i rritjes së normës së interesit në kredi (grafiku 30).

Grafik 30. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK.

Struktura e kredive sipas llojit të normave të interesit ka vazhduar të lëviz në favor të kredive me normë fikse të interesit. Më konkretisht, në qershor 2025, pjesëmarrja e kredive me normë fikse të interesit

arriti në 71.7 përqind nga 69.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu, nga tremujori paraprak kjo pjesëmarrje ka shënuar rritje prej 1.2 pikë përqindje (grafiku 31).


Grafik 31. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit



Burimi: BQK.


Në qershor 2025, norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare arriti në 6.5 përqind, apo rritje vjetore për 0.2 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin paraprak, kjo normë është rritur për 0.5 pikë përqindje. Në kuadër të KJF-ve, norma mesatare e interesit ka shënuar rritje për sektorin e industrisë dhe shërbimeve, si në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ashtu edhe krahasuar me fundin e tremujorit paraprak, duke arritur në një mesatare prej 6.4 përqind dhe 6.5 përqind, respektivisht (grafiku 32). Në anën tjetër, norma e interesit për sektorin e bujqësisë ka shënuar rënie vjetore për 0.6 pikë përqindje, duke zbritur në 7.8 përqind, ndërsa mbeti pothuajse e pandryshuar krahasuar me tremujorin e kaluar.

Grafik 32. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.

Grafik 33. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare arriti në 6.1 përqind, duke shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje nga viti paraprak dhe për 0.8 pikë përqindje nga marsi i këtij viti. Në kuadër të ekonomive familjare, norma e interesit për kreditë konsumuese arriti në 6.3 përqind, duke shënuar rritje prej 0.3 pikë përqindje nga qershori 2024 dhe 0.7 pikë përqindje nga tremujori paraprak. Po ashtu, norma për kreditë hipotekare u rrit në 5.4 përqind, përkatësisht 0.4 pikë përqindje më shumë se një vit më parë dhe 0.6 pikë përqindje më shumë krahasuar me fundin e tremujorit të kaluar (grafiku 33).

Rënia e përgjithshme në normën e interesit në gjithsej depozitat u ndikua nga ulja e normës së interesit në depozitat e ekonomive familjare, pasi që ato të korporatave jofinanciare u karakterizuan me rritje. Më konkretisht, norma mesatare e interesit në depozita për ekonomitë familjare ka shënuar rënie për 0.2 pikë


përqindje nga qershori i vitit të kaluar dhe marsi i këtij viti, duke zbritur në 2.5 përqind (grafiku 34). Në anën tjetër, për korporatat jofinanciare, norma mesatare e interesit në depozita ka shënuar rritje vjetore për 0.3 pikë përqindje, duke arritur në 3.6 përqind. Po ashtu, krahasuar me marsin e këtij viti, kjo normë ka shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje.

Fitimi neto i sektorit bankar ishte 87.3 milionë euro, që paraqet rënie në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (90.93 milionë euro), përkatësisht apo rënie vjetore prej 4.0 përqind, nga 10.1 përqind rritje një vit më parë. Kjo dinamikë, ashtu si në tremujorin paraprak, ishte rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes më të ngadalësuar të të hyrave. Të hyrat arritën në 264.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.7 përqind nga 18.2 përqind një vit më parë. Rritja e ngadalësuar e të hyrave u ndikua kryesisht nga të hyrat nga interesi, të cilat përbëjnë rreth 78.0 përqind të gjithsej të hyrave dhe shënuan rritje prej 12.2 përqind nga 21.8 përqind në vitin e kaluar. Më konkretisht, të hyrat nga interesi nga kreditë u rritën për 15.0 përqind nga 26.6 përqind në vitin paraprak, si rezultat i uljes së normës së interesit dhe efektit të bazës. Po ashtu, ndikuar nga rënia e investimeve në letra me vlerë, të hyrat e interesit nga kjo kategori ngadalësuan ritmin e rritjes në 34.1 përqind nga 55.0 përqind një vit më parë. Ndërsa, të hyrat nga plasmanët me bankat shënuan rënie, duke zbritur në 6.7 milionë euro nga 12.2 milionë euro në qershor të vitit të kaluar. Kategoria e të hyrat nga jo interesi - e që janë kryesisht të hyra nga tarifat dhe komisionet – shënuan rritje vjetore të përshpejtuar prej 10.2 përqind nga 6.2 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 52.2 milionë euro në fund të qershorit 2025.

Shpenzimet e sektorit arritën në 177.6 milionë euro, rritje vjetore prej 19.7 përqind nga 23.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ashtu si në tremujorin paraprak, ky zhvillim u ndikua nga rritja më e ulët e shpenzimeve të interesit, si dhe e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative. Më konkretisht, shpenzimet e interesit arritën në 36.3 milionë euro, duke shënuar ngadalësim të rritjes vjetore në 37.8 përqind nga 47.5 përqind në vitin paraprak, ndikuar nga rënia e normave të interesit në depozita dhe efektit të bazës së lartë nga viti i kaluar. Tutje, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar, prej 10.0 përqind nga 21.4 përqind në vitin paraprak.


Rritja më e ulët e fitimit të sektorit në raport me rritjen e kapitalit, ndikoi që treguesi i Kthimit në Kapital të zbres në 17.9 përqind nga 19.1 përqind një vit më parë. Po ashtu, Kthimi në Asete ka shënuar rënie vjetore për 0.2 pikë përqindje, duke zbritur në 2.3 përqind, si rezultat i rritjes së përshpejtuar të aseteve në raport me rritjen më të ngadalësuar të fitimit (grafiku 35).

Grafik 34. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.

Grafik 35. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Raporti i kredive jo-performuese zbriti në 2.0 përqind, duke shënuar rënie të lehtë prej 0.1 pikë përqindje nga viti paraprak. Kjo u ndikua nga rritja më e ngadalësuar e vlerës së kredive jo-performuese në raport me rritjen e shpejtë të gjithsej kredive (grafiku 36). Më konkretisht, vlera e kredive jo-performuese ka shënuar rritje prej 11.7 përqind nga 21.2 përqind një vit më parë, ndërsa gjithsej kreditë përsheptuan rritjen në 19.3 përqind nga 13.4 përqind. **Megjithatë, krahasuar me tremujorin paraprak, raporti i kredive jo-performuese ka shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje.** Tutje, mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë shënoi rënie, duke zbritur në 115.4 përqind nga 125.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe 125.8 përqind në mars të këtij viti.

Raporti i kredive jo-performuese, ashtu si në tremujorin paraprak, ka shënuar rënie vjetore si për segmentin e korporatave jofinanciare edhe atë të ekonomive familjare. Më konkretisht, raporti i kredive jo-performuese për korporatat jo-financiare zbriti në 2.4 përqind nga 2.5 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare zbriti në 1.4 përqind nga 1.7 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje dukshëm më të ngadalësuar të ekspozimeve jo-performuese, apo rritje prej 3.5 përqind nga 55.8 përqind një vit më parë. Krahasuar me tremujorin paraprak, raporti i kredive jo-performuese për ekonomitë familjare mbeti thuajse i pandryshuar, me rënie marginale prej vetëm 0.02 pikë përqindje. Ndërsa, korporatat jofinanciare shënuan rritje vjetore të përsheptuar të ekspozimeve jo-performuese në 15.3 përqind nga 10.0 përqind një vit më parë. Kontributin kryesor në rritjen e kredive jo-performuese në kuadër të KJF-ve e kishte sektori i tregtisë, i cili ka shënuar rritje prej 49.8 përqind. Megjithatë, kjo rritje kryesisht u ndikua nga zhvillime të veçanta në një institucion dhe nuk paraqet dinamikë të përgjithshme të sektorit. Po ashtu, me rritje të nivelit të kredive jo-performuese u karakterizua sektori i komunimit i cili ka shënuar rritje vjetore të ekspozimeve jo-performuese prej 125.5 përqind, duke arritur nivelin prej 3.2 përqind nga 1.3 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, sektorët e bujqësisë, prodhimit dhe ndërtimit dhe patundshmërive, kanë shënuar rënie të raportit të kredive jo-performuese për 0.4 pikë përqindje, duke zbritur në 6.7 përqind bujqësinë dhe 2.6 përqind për sektorët e tjerë.


Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, arriti në 16.5 përqind nga 16.0 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, krahasuar me tremujorin e kaluar, ky tregues shënoi rritje për 0.3 pikë përqindje. Rritja e lehtë e normës së kapitalizimit u ndikua nga rritja më e lartë e kapitalit në raport me rritjen e mjeteve të peshuara me rrezik. Konkretisht, kapitali rregullativ i sektorit shënoi rritje vjetore prej 18.0 përqind nga 16.2 përqind një vit më parë. Kapitali rregullativ i sektorit mbetet me cilësi të lartë, i mbështetur kryesisht nga rritja e fitimit të mbajtur dhe shtimi i kapitalit. Brenda strukturës së kapitalit, 88.3 përqind përbëhet nga kapitali i klasit të parë, ku 64.4 përqind zë pjesë fitimi i mbajtur. Po ashtu, për dallim nga qershori i vitit paraprak, është

Grafik 36. Ndryshimi vjetor i vlerës së KJP-ve dhe Raporti i KJP-ve ndaj gjithsej kredive



Burimi: BQK.


Grafik 37. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

rritur shfrytëzimi i instrumenteve të kapitalit shtesë të klasit të parë, si dhe kapitalit të klasit të dytë, për përfundimin tutje të pozicionit të përgjithshëm të kapitalit. Kurse, mjetet e peshuara me rrezik shënuan rritje prej 14.6 përqind nga 10.6 përqind në qershor 2024 (grafiku 37).

Grafik 38. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Trendi i rënies për treguesit e likuiditetit dhe financimit ka vazhduar edhe gjatë TM2 2025, megjithatë pozicioni i likuiditetit mbetet i qëndrueshëm me vlerat e treguesëve mbi nivelin e kërkuar rregullator.

Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) zbriti në 174.6 përqind në qershor 2025, duke shënuar rënie për 29.6 pikë përqindje nga viti paraprak dhe 10.8 pikë përqindje nga tremujori i kaluar, por mbetet lartë mbi minimumin prej 100 përqind të kërkuar me rregullore. Ky nivel indikon se bankat mbajnë mjaftueshëm mjete likuide për të plotësuar nevojat dalëse (rrjedhjes së parasë) përgjatë 30 ditëve kalendarike të periudhës stresuese. Teprica e likuiditetit në qershor 2025 ishte 3.1 përqind më e lartë se një vit më parë, ndërsa rrjedha dalëse neto e likuiditetit ishte 20.6 përqind më e lartë për të njëjtën periudhë krahasuese. Po ashtu, edhe treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) shënoi rënie në 133.0 përqind nga 142.5 përqind në qershor 2024 dhe rënie për 1.8 pikë përqindje nga tremujori i parë i këtij viti, por mbetet mbi minimumin rregullativ prej 100 përqind duke sugjeruar se bankat disponojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për të mbuluar kërkesat më afatgjata të financimit/likuiditetit. Ndërsa, raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurta - ka qëndruar në nivelin e njëjtë prej 29.8 përqind. Kjo si rezultat i rritjes vjetore të përafërt të detyrimeve afatshkurtra me 15.9 përqind në raport me rritjen prej 15.6 përqind të mjeteve likuide. Në anën tjetër, rritja më e shpejtë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen e raportit kredi-depozitë për 5.3 pikë përqindje, duke arritur në 92.5 përqind (grafiku 38).


4.2. Sektori pensional

Sektori pensional në tremujorin e dytë 2025 u karakterizua me rikuperim të investimeve pas zhvillimeve të pafavorshme të tremujorit të parë, kur kthimet nga investimet u ndikuan negativisht nga luhatjet dhe pasiguritë në tregjet financiare ndërkombëtare. Stabilizimi gradual i kushteve globale financiare gjatë TM2 2025 u reflektua në përmirësim të kthimeve dhe në vazhdimësinë e rritjes së asetëve dhe kontributeve. Në fund të qershorit 2025, asetet e sektorit pensional arritën në 3.4 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 15.0 përqind (grafiku 39). Dinamika e sektorit mbetet kryesisht e përcaktuar nga FKPK, që përfaqëson 99.7 përqind të asetëve, dhe shënoi rritje vjetore prej 15.1 përqind nga 15.8 përqind në TM2 2024. Ndërkohë, FSKP shënoi ngadalësim, me rritje vjetore prej vetëm 4.2 përqind kundrejt 11.8 përqind në TM2 2024.

Portofoli i investimeve të dy fondeve pensionale vazhdon të karakterizohet nga ekspozimi në tregjet e jashtme, i cili shënoi rritje këtë tremujor si rezultat i rikuperimit të tregjeve globale financiare pas luhatjeve në fillimvit. FKPK rriti ekspozimin në tregun e jashtëm me 18.4 përqind në TM2 2025 nga 9.6 përqind në TM1 2025, ndonëse më e ulët se rritja prej 29.6 përqind në TM2 2024. Investimet e jashtme përbëjnë 80.3 përqind të totalit të portofolit, me 99.9 përqind të tyre në fonde të përbashkëta. Ndërkohë, investimet në tregun e brendshëm shënuan rritje modeste prej 3.2 përqind, duke reflektuar ngadalësim krahasuar me TM1 2025 (20.9 përqind), por përmirësim të konsiderueshëm nga rënia prej 16.0 përqind në TM2 2024. Brenda tregut vendor, letrat me vlerë vazhdojnë të dominojnë me 75.8 përqind të portofolit. FSKP mbajti 21.9 përqind të mjeteve të investuara në tregun e brendshëm dhe 78.1 përqind në tregun e jashtëm, ndërkohë që, rritje më e lartë u shënuar në tregun e brendshëm.


FKPK realizoi kthim bruto pozitiv prej 62.5 milionë euro në fund të TM2 2025, nga kthimi negativ prej 40.3 milionë euro që e karakterizoi në tremujorin e parë të vitit. Sidoqoftë, kthimi kumulativ i gjysmës së parë të vitit mbetet shumë më i ulët krahasuar me 117.8 milionë euro kthim në të njëjtën periudhë të vitit 2024. Kthimi pozitiv në TM2 pasqyroj performancën më të mirë të tregjeve financiare ndërkombëtare,

Grafik 39. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK.

Grafik 40. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP.

Grafik 41. Performanca e FKPK-së




Burimi: FKPK.

pas rënieve të theksuara të tremujorit të parë. Si rrjedhojë, cmimi i njësisë së aksioneve u rrit lehtësisht në 1.85 euro nga 1.75 euro në fund të TM2 2024, dhe 1.79 euro nga TM1 2025. FSKP realizoi kthim bruto prej 23.3 mijë euro në TM2 2025, dukshëm më ulët krahasuar me kthimin prej 737.8 mijë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë, por një rikuperim të dukshëm nga rezultati negativ i TM1 2025 prej 240.7 mijë euro (grafiku 40). Çmimi i aksioneve të FSKP-së shënoi rritje në 2.13 euro për njësi, nga 2.11 euro një vit më parë.

Vlera e kontributeve të arkëtuara në sektorin pensional në gjysmën e parë të vitit 2025 arriti në 175.2 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.1 përqind.

Faktorë me ndikim pozitiv në rritjen e kontributeve ishte rritja e njësisë së koeficientit për shërbyesit civil në fillim të vitit. Sektori dominohet nga kontributet e FKPK-së me pjesëmarrje prej 99.7 përqind, vlera e të cilave shënoi rritje vjetore prej 14.2 përqind, nga 13.6 përqind një vit më parë (grafiku 41). Ndërkohë, kontributet e arkëtuara nga FSKP-ja shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 42.1 përqind në fund të TM2 2025, pas një rënie prej 2.0 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur në 469.1 mijë euro (grafiku 42).

Grafik 42. Performanca e FSKP-së




Burimi: FSKP.

4.3. Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve shënoi ritëm më të ngadalësuar të rritjes vjetore të aseteve, duke reflektuar ngadalësimin e rritjes së primeve të shkruara, me ndikimin më të madh nga segmenti dominues i sigurimeve jo-jetë.

Në fund të qershorit 2025, asetet e sektorit shënuan vlerën prej 349.3 milionë euro, me rritje vjetore prej 5.8 përqind krahasuar me 12.2 përqind në të njëjtën periudhë të vitit paraprak (Grafiku 43). Struktura e sektorit dominohet nga sigurimet “jo-jetë” që përfaqësojnë 91.6 përqind të aseteve, ndërsa sigurimet “jetë” mbulojnë 8.4 përqind. Struktura e aseteve mbeti e orientuar kryesisht në instrumente me rrezik të ulët dhe likuiditet të lartë, ku dominuan depozitat bankare dhe letrat me vlerë. Depozitat bankare shënuan rritje vjetore prej 15.1 përqind duke rritur pjesëmarrjen në totalin e aseteve nga 46.1 përqind në 50.1 përqind. Ndërsa, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si kategoria e dytë më e rëndësishme në portofol, shënuan kthesë në normën e rritjes, duke kaluar nga rritja prej 9.8 përqind në qershor 2024 në tkurrje prej 3.6 përqind në qershor 2025. Si rezultat, pjesëmarrja e tyre në strukturën e aseteve zbriti nga 16.1 përqind në 14.6 përqind. Ngjashëm, asetet e risigurimit (rezervat teknike të risiguresve) shënuan rënie vjetore prej 5.6 përqind nga rritja prej 21.9 përqind në qershor 2024, duke zbritur pjesëmarrjen e tyre në totalin e aseteve në 14.3 përqind nga 16.0 përqind një vit më parë.


Grafik 43. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.

Vlera e primeve të shkruara bruto shënoi ngadalësim të konsiderueshëm të ritmit vjetor të rritjes, në 5.7 përqind nga 18.0 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafiku 44). Segmenti i sigurimit “jo-jetë” shënoi rritje vjetore të ngadalësuar, në 5.7 përqind nga 18.5 përqind një vit më parë. Ngjashëm sigurimi i jetës shënoi ngadalësim, në 6.4 përqind nga 9.4 përqind. Në të njëjtën periudhë, numri i policave zbriti në 843,093, që paraqet rënie vjetore prej 13.8 përqind. Në sigurimin “Jo-Jetë”, kategoria *Përgjegjësia motorike ndaj palës së tretë* (MTPL e brendshme) mbetet dominuese, duke rritur përfaqësimin në 53.4 përqind të totalit të primeve nga 51.9 përqind një vit më parë. Kjo kategori shënoi rritje vjetore të ngadalësuar të primeve, prej 9.6 përqind nga 11.7 përqind në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Në sigurimin e jetës, kategoria dominuese “*Jeta e Debitorit*” shënoi rritje vjetore prej 5.35 përqind nga rritja prej 17.1 përqind të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Grafik 44. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Për dallim nga primet të cilat shënuan rritje më të ngadalshme, dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan rritje vjetore të përsheptuar, përkatësisht rritje prej 21.1 përqind kundrejt rënies prej 3.4 përqind në gjysmën e parë të vitit paraprak (grafiku 44). Dëmet a paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 25.1 përqind nga një rënie prej 5.4 përqind, ndërsa dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan rënie vjetore prej 13.8 përqind, në kontrast me rritjen prej 19.0 përqind të shënuar në periudhën paraprake. Ndërkohë, dëmet e mbuluara nga risiguruesit u rritën ndjeshëm, duke u dyfishuar në krahasim me një vit më parë. Në kuadër të dëmeve të paguara në sigurimin e jo-jetës, kategoria *‘Përgjegjësia motorike ndaj palëve të treta’*, me pjesëmarrje 54.2 përqind, shënoi rritje vjetore prej 11.3 përqind dhe arriti në 22.4 milionë euro. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga dëmet e lidhura me policat kufitare dhe MTPL-të e brendshme. Ndërkohë, kategoria *‘Sigurimi i sëmundjeve’*, që përbënte 25.8 përqind të totalit, shënoi rritje vjetore prej 11.6 përqind, duke arritur në 10.6 milionë euro.

Pas trendit rënës të shënuar në periudhën janar–qershor 2024, dëmi mesatar shënoi rritje me 9.27 përqind në gjashtëmuorin e parë të vitit 2025, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, zhvillim që mund të lidhet me shtimin e dëmeve me vlera më të larta, rritjen e kostove të riparimeve dhe shërbimeve, si dhe me presionet inflacioniste në treg.

Fitimi neto i sektorit të sigurimeve shënoi rritje vjetore prej 6.3 përqind, duke arritur në 9.3 milionë euro. Të hyrat totale, të mbështetura kryesisht nga primet e shkruara, u rritën me 6.4 përqind dhe arritën në 75.0 milionë euro, ndërsa shpenzimet, të dominuara nga dëmet e paguara, u zgjeruan me të njëjtin ritëm prej 6.4 përqind, duke arritur vlerën prej 65.7 milionë euro. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të pranuar u rrit në 47.4 përqind në qershor 2025, nga 42.1 përqind një vit më parë, për shkak të rritjes më të shpejtë të dëmeve krahasuar me primet. Kjo dinamikë u reflektua edhe në raportin e kombinuar, i cili shënoi rritje të lehtë në 90.4 përqind nga 89.4 përqind në qershor 2024, duke reflektuar ngarkesë më të lartë të dëmeve. Përveç rritjes së dëmeve, në raportin e kombinuar ndikoi edhe rritja e lehtë e raportit të shpenzimeve në 33.8 përqind nga 32.3 përqind një vit më parë (grafiku 44).

Treguesit e profitabilitetit shënuan zhvillime të ndryshme. Kthimi mesatar në asete (KMA)⁴ u rrit lehtë në 5.6 përqind nga 5.5 përqind, mbështetur nga zgjerimi më i shpejtë i fitimit bruto vjetor krahasuar me rritjen më të ngadalshme të aseteve mesatare. Ndëkohë, kthimi mesatar në kapital (KMK) shënoi rënie të konsiderueshme në 17.5 përqind nga 23.5 përqind, si pasojë e rënies së fitimit neto vjetor dhe rritjes më të shpejtë të kapitalit mesatar.

Treguesit e kapitalizimit dhe likuiditetit mbetën mbi nivelet minimale dhe shënuan rritje vjetore në nivel të përgjithshëm (tabela 1). Në segmentin jo-jetë, përmirësimi i raportit të kapitalit ndaj marginës së solvencës dhe fondit garantues u mbështet nga rritja e kapitalit vetanak. Në segmentin jetë, megjithëse kapitalizimi mbetet mbi kërkesën minimale, rënia e raportit ndaj marginës së solvencës pasqyron rritje të kërkesave për kapital dhe ulje të fitimit neto. Ndërkohë, treguesit e likuiditetit ruajnë pozitë solide, me rritje të mjetëve likuide në raport me detyrimet dhe provizionet teknike, veçanërisht në segmentin jo-jetë.


Tabela 1. Treguesit e Qëndrueshmërisë

Përshkrimi	Qershor 2025	Qershor 2024	Ndryshimi Vjetor
Kapitali në raport me marginën e solvencës (jo-jetë)	166.3%	146.2%	13.7%
Kapitali në raport me marginën e solvencës (jetë)	658.1%	777.3%	-15.3%
Kapitali në raport me fondin garantues (jo-jetë)	194.6%	156.8%	24.1%
Kapitali në raport me fondin garantues (jetë)	178.3%	166.6%	7.0%
Mjetet likuide në raport me provizionet teknike (jo-jetë)	95.7%	90.7%	5.5%
Mjetet likuiden në raport me provizione teknike (jetë)	151.5%	156.5%	-3.2%
Mjetet likuide në raport gjithsej detyrimet (jo-jetë)	83.6%	78.9%	6.0%
Mjetet likuide në raport gjithsej detyrimet (jetë)	143.4%	142.80%	0.4%

4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar

Ngjashëm me dinamikën në tremujorin e parë, edhe gjatë tremujorit të dytë sektori u karakterizua me zgjerim vjetor dyshifror të aseteve, prej 18.2 përqind, ndonëse me ritëm më të ngadalësuar se rritja 32.1 përqind në vitin paraprak. Kjo dinamikë reflekton trendin e ngadalësuar të rritjes së burimeve të jashtme të financimit. Asetet e sektorit arritën në 671.3 milionë euro, të dominuara kryesisht nga kreditë, pasuar nga lizingjet dhe mjetet likuide të mbajtura në bankat komerciale

Grafik 45. Asetet e sektorit mikrofinanciar




⁴ Për llogaritjen e treguesve KMA dhe KMK merret fitimi vjetor rotullues (TVM – Trailing Twelve Months), i cili përfshin të dhënat e 12 muajve të fundit nga periudha raportuese.

(grafiku 45). Financimi mbeti i orientuar kryesisht nga huamarrja nga jashtë, e cila shënoi rritje vjetore prej 13.5 përqind, dukshëm më e ngadalësuar krahasuar me 25.0 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në të njëjtën kohë, financimi nga sektori i brendshëm shënoi rritje vjetore të konsiderueshme prej 139.4 përqind nga 22.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke reflektuar rritjen e rëndësisë së burimeve të brendshme në strukturën e përgjithshme të financimit.

Stoku i kredive të sektorit arriti në 499.7 milionë euro, duke vazhduar me trendin e lartë të rritjes prej 26.0 përqind nga 23.3 përqind një vit më parë. Kreditimi për ekonomitë familjare shënoi rritje vjetore prej 24.0 përqind nga 17.5 përqind në qershor 2024, ndërsa Kreditimi për korporatat jofinanciare me rritje vjetore prej 29.1 përqind nga 32.9 përqind në qershor 2024 (grafiku 46). Rritja më e shpejtë e portofolit të kredive për ndërmarrjet, në raport me atë të ekonomive familjare, u reflektua në ndryshime të lehta në strukturë, me rënie të pjesëmarrjes së kredive për ekonomitë familjare në 58.8 përqind nga 59.8 përqind dhe rritje të pjesëmarrjes së kredive për korporatat jofinanciare në 41.2 përqind nga 40.2 përqind. Të gjithë sektorët e ekonomisë shënuan rritje, ndër të cilët sektori i industrisë shënoi rritjen më të lartë prej 26.7 përqind. Por, për shkak të peshës më të lartë në portfolion e kredive të korporatave jo-financiare të sektorit të shërbimeve tjera, i cili po ashtu shënoi rritje të lartë prej 24.9 përqind, ky sektor kishte kontributin më të lartë në rritje.


Lizingu ka shënuar rënie të pjesëmarrjes në asetet e sektorit mikrofinanciar, duke zbritur në 10.8 përqind nga 13.9 përqind një vit më parë, si rezultat i rënies vjetore të aktivitetit të lizingut prej 7.5 përqind. Ky zhvillim ishte më i theksuar në segmentin e korporatave jofinanciare, i cili dominoi strukturën me 63.2 përqind të totalit të lizingut në qershor 2025. Ngashëm, lizingu për ekonomitë familjare shënoi rënie vjetore prej 10.4 përqind, në krahasim me rritjen prej 4.2 përqind të shënuar një vit më parë (Grafiku 47).

Grafik 46. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.

Grafik 47. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

(Grafiku 47).


Norma mesatare e interesit për kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar shënoi rënie këtë tremujorë, veçanërisht për ekonomitë familjare, ku ato u ulën me 3.6 pikë përqindje, ndërsa për korporatat jofinanciare zbritën me 1.0 pikë përqindje (grafiku 48). Ekonomitë familjare kishin norma më të larta të interesit në raport me KJF-të, për 6.8 pikë përqindje. Në Qershor 2025, norma e interesit për kreditë konsumuese zbriti për 1.2 pikë përqindje në 23.2 përqind dhe norma e interesit për kreditë hipotekare u rrit për 1.4 pikë përqindje në 17.3 përqind. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, normat e interesit shënuan rënie për të gjithë sektorët e ekonomik, ndërsa kreditë për sektorin e shërbimeve u karakterizuan me normën më të favorshme prej 16.1 përqind (grafiku 49).

Fitimi neto i sektorit arriti në 10.7 milionë euro, duke shënuar ngadalësim të rritjes vjetore në 8.6 përqind nga 22.2 përqind rritje një vit më parë. Ky zhvillim pasqyron ndikimin më të madh të rritjes së shpenzimeve krahasuar me të hyrat. Të hyrat e përgjithshme të sektorit vazhduan rritjen e lartë gjatë periudhës raportuese, prej 20.2 përqind, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, duke pasqyruar stabilizimin e normave të interesit dhe ndër tjera edhe efektin e bazës më të lartë krahasuese.


Rritja vazhdoi të mbështetet kryesisht nga të hyrat nga interesi, të cilat mbetën burimi dominues i të hyrave, duke reflektuar zgjerimin e aktivitetit kreditues. Edhe të hyrat nga jo-interesi kontribuan në rritje, megjithëse me një ritëm shumë më modest sesa vitin e kaluar. Shpenzimet e përgjithshme gjithashtu ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore në 24.1 përqind nga 41.1 përqind, duke reflektuar stabilizimin gradual të kostove pas rritjes së theksuar në vitet e fundit të ndikuar nga inflacioni dhe kosto e lartë e financimit. Kontributin kryesor në këtë ngadalësim e dhanë shpenzimet e jo-interesit (18.4 përqind nga 20.3 përqind), të cilat vijuan rritjen, por me intensitet më të ulët, veçanërisht në kategorinë e shpenzimeve për personel dhe ato administrative (8.6 përqind nga 17.2 përqind). Në anën tjetër, shpenzimet e interesit shënuan rritje prej 34.1 përqind, ndonëse paraqet ngadalësim të theksuar nga 84.6 përqind krahasuar me vitin paraprak, në përputhje me normalizimin e kushteve të financimit.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave u rrit në 79.1 përqind në qershor 2025, nga 75.3 përqind një vit më parë, duke reflektuar rritjen lehtësisht më të shpejtë të shpenzimeve në raport me të hyrat. Rrjedhimisht, indikatorët kryesorë të profitabilitetit shënuan rënie, me kthimin mesatar në asete (KMA) që zbriti në 3.5 përqind nga 4.2 përqind dhe kthimin mesatar në kapital (KMK) që zbriti nga 14.4 përqind në 12.4 përqind.

Grafik 48. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Grafik 49. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Raporti i kredive joperformuese ndaj totalit të kredive në sektorin e institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare zbriti në 1.8 përqind nga 1.9 përqind në fund të qershorit 2024, si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të stokut të përgjithshëm të kredive krahasuar me kreditë joperformuese.


Mbulueshmëria e këtyre kredive me provizione vazhdoi të jetë e qëndrueshme, megjithëse zbriti lehtë në 140.0 përqind nga 145.5 përqind në periudhën paraprake (grafiku 51). Nga ana tjetër, raporti i kredive jo-performuese mbetet më i lartë për institucionet financiare jo-bankare (IFJB) krahasuar me institucionet mikrofinanciare (IMF). Për IMF-të, ky raport shënoi rënie në 1.6 përqind nga 1.7 përqind, ndërsa për IFJB-të shënoi rritje në 3.1 përqind nga 2.8 përqind në periudhën paraprake (grafiku 52).

Grafik 50. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 51. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK.

Grafik 52. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.




Burimi: BQK.

4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës


Në tremujorin e dytë të vitit 2025, Qeveria e Republikës së Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 48.8 milionë euro, duke shënuar përgjysmim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (grafiku 53). Megjithatë, raporti i borxhit të brendshëm ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV) zbriti lehtësisht në 8.27 përqind nga 9.06 përqind në qershor 2024, ndikuar kryesisht nga amortizimi i borxhit të brendshëm.

Grafik 53. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 54. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturitet, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Pavarësisht normës më të ulët të kthimit, kërkesa për letrat me vlerë mbeti e lartë dhe tejkaloi ofertën. Megjithatë, qeveria emetoi 20.5 milionë euro më pak se shuma e kërkuar (grafiku 53).

Struktura e investitorëve të letrave me vlerë qeveritare mbeti e ngjashme me tremujorin paraprak. Fondet pensionale vazhduan të dominojnë tregun, duke zotëruar 45 përqind të stokut total, pasuar nga bankat komerciale dhe institucionet publike me nga 23 përqind secila, ndërsa kompanitë e sigurimit përfaqësuan 5 përqind të stokut të borxhit qeveritar.

Gjatë këtij tremujori, letrat me vlerë të emetuara janë të dominuara nga obligacionet shtatëvjeçare, pasuar nga obligacionet trevjeçare dhe ato dyvjeçare (grafiku 54).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 51, TM2 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)
- c) Regjistri i Kredive të Kosovës: Regjistri i Kredive - BQK (bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: Ballina | FKPK (trusti.org)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntëmujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntëmujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

ECB (BQE): Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu); Key ECB interest rates (europa.eu)

FAO: Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations (fao.org)

IMF (FMN): International Monetary Fund (IMF)

World Economic Outlook: World Economic Outlook (imf.org)

World Bank: Commodity Markets: [Commodity Markets \(www.worldbank.org\)](http://www.worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org